

SHËNDETI SI KONSTRUKT SOCIAL

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË SOCIOLOGJI

NGA

FJOLLA KRYEZIU



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

PRISHTINË

SHTATOR 2021

Rezyme e temës Master

Shëndeti si konstrukt social

Studentja: Fjolla Kryeziu

Mentori: Prof. Dr. Ardian Gola

Shëndeti është më shumë se sa thjesht një gjendje biologjike e organizmit të njeriut, respektivisht paraqet një koncept më të gjerë se aq ku përfshihen edhe ana sociale e psikologjike e tij. Funkcionet dhe idetë e individëve legjitimohen në momentin kur ato bëhen të pranueshme nga strukturat më të larta të shoqërisë. „Shëndeti si konstrukt social“ trajton kompleksitetin e konceptit të shëndetit duke u bazuar edhe në aspekte të tjera, si ato sociale e kulturore, përveq anës shkencore të mjekësisë dhe prizmit profesional. Shëndeti dhe sëmundjet janë pjesë e paevitueshme e zhvillimit të procesit jetësor të secilit individ. Shëndeti nuk është thjesht vetëm procesi dhe gjendja biologjike në të cilën ndodhet organizmi i njeriut me rastin e shfaqjes së sëmundjes, por ai paraqet një koncept më të gjerë në të cilin implikohen edhe aspektet e tjera socio-kulturore që vijnë si rrjedhojë e përkatësisë në një grup shoqëror e kulturor.

Ky punim si pikënisje ka trajtimin e ndërlidhjes ndërmjet faktorëve të ndryshëm social dhe ndikimit që kanë këta faktorë mbi shëndetin e individëve dhe në mënyrën se si perceptohet shëndeti dhe trajtimi i tij

Është trajtuar dhe analizuar konceptin teorik të shëndetit në korrelacion me faktorët social si gjinia, moshja dhe ndikimin e tyre në formësimin e këtij koncepti. Individët u takojnë grupeve të ndryshme sociale, ekspozohen para një numri të normave dhe vlerave me të cilat funksionon shoqëria. Zhvillimi i proceseve të tjera sociale si interaksionet me të tjerët, procesi i socializimit, edukimit, etj., të gjitha këto ndikojnë në krijimin e bindjeve të caktuara të cilat bartin individët dhe perceptimet mbi atë se çka konsiderohet normale e çka jo, e mirë apo e keqe, i shëndoshë apo i sëmurë.

Kjo tezë është ndërtuar kryesisht mbi dy rryma sociologjike, atë të struktural-funksionalizmit dhe pikëpamjes së Fukosë mbi sistemin shëndetësor. Që të dyja trajtojnë shëndetin dhe sëmundjen nga dy prizme të kundërta, megjithatë ndajnë dhe pika përafruese gjatë trajtimit të kësaj tematike. Nisur nga perspektiva struktural-funksionaliste e bazuar kryesisht mbi teorinë e T. Parsonsit, sëmundjen e konsiderojmë si dalje nga norma e funksionit normal të individit brenda

grupit shoqëror, kurse nisur nga M. Fuko problematika kryesore shfaqet në kuadër të trajtimit të sistemit shëndetësor, institucionalizimit të dijes dhe bartjen e këtij pushteti në pika udhëheqëse.

Qasja "kulturoantropologjike" ndaj trajtimit përqendrohet te pacientët dhe është rezultat i një dialogu të vërtetë ku mjeku merr parasysh përvojën subjektive të personit të sëmurë, duke hulumtuar simptomat dhe orinetimi drejt një diagnostike të saktë, krahas vlerësimit gjendjes mendore, fizike dhe emocionale.

Është bërë një analizë e procesit të medikalizimit, historisë së shfaqjes së këtij procesi, zhvillimit të tij dhe impaktin që ka ky proces në avancimin e mjekësisë. Shfaqja e simptomave të sëmundjes dhe hyrja në "rolin e të sëmurit" është e konsideruar si sjellje devijante nga ajo çka shihet si normale në shoqëri. Me këtë rast edhe kjo sjellje devijante duhet trajtuar me të njejtën metodë ndonëse mjeti ndryshon. Si formë e duhur për t'iu çasur kësaj sjelljeje devijante del të jetë medikalizimi.

Trajtimi i stilit të jetës dhe raportet e tij me shëndetin janë problematikë tjetër e trajtuar dhe analizuar në temë. Sjelljet të cilat manifestojnë individët pas identifikimit dhe diagnostifikimit të sëmundjes janë të ndryshme nga ato sjellje që individët manifestojnë si rrjedhojë e masave preventive të sëmundjes apo edhe si formë e mbrojtjes dhe mbarëvajtjes së një gjendjeje stabile shëndetësore.

Çështja tjetër e trajtuar është analizimi i raporteve të personelit shëndetësor dhe pacientëve me ndikim të rëndësishëm në shëndet. Sociologjia mjekësore, si pjesë krejt specifike e sociologjisë si shkencë, do të duhej të merrej drejtpërdrejt me hulumtimin e raporteve sociale dhe profesionale që zhvillohen ndërmjet pacientit dhe punonjësve shëndetësorë.

Së fundmi është analizuar sistemi shëndetësor në Kosovë në formë case study, duke e analizuar me të dhëna statistikore, si strukturë organizative dhe shërbyese në gjithë shtrirjen e saj, funksionimin e këtij sistemi, problematikat që bart me vete dhe politikat shëndetësore që janë në funksion.

Shëndeti tejkalon edhe vetë definicionin e OBSH, sepse në vetëvete ngërthen komponente tjera që kërkojnë strukturim përtej mungesës së sëmundjes. Konstrukti social i shëndetit shkon përtej koncepteve të thjeshta mbi shëndetin, duke përfshirë komponente të shumta brenda vetes, nisur prej asaj se sëmundja është proces patologjik, por që pa trupin ajo nuk do të mund të kishte ndikimn e saj, prandaj strukturimi social i sëmundjes jep koncept më të gjërë të saj.